



NEON A.S
RR.XHANFISE KEKO, ND.168 , H.1, CP. 1005
TIRANA, ALBANIA
TEL: +355 42 377 773 FAX:: +355 42 347 770
E-MAIL: INFO@NEON.AL WEB: WWW.NEON.AL

**NEON RS ROAD PAINT
(BOJE RRUGESH)
Skedë Teknike**

PËRSHKRIMI: RS ROAD PAINT është një bojë e bazuar në rezina akrelike dhe tretësa e cila përdoret për të shënuar rrugët. Thahet shumë shpejt, Brenda 60 minutave mund të shkelet mbi sipërfaqen e lyster. Ka rezistencë të madhe në ngjitje, fërkim dhe jetëgjatësi. RS ROAD PAINT e ruan shkëlqimin edhe pas aplikimit në të gjitha kushtet atmosferike. Në përbërje të saj ka rruaza qelqi që e bëjnë këtë produkt refleks. Përveç kësaj, përzierja e saj me rërë të veçantë rrit fërkin dhe eviton rrëshqitjen. Gjendet në këto ngjyra: e bardhë, e verdhë dhe sipas dëshirës.

FUSHA E PËRDORIMIT: RS ROAD PAINT përdoret për të shënuar në rrugët e asfaltuara, në ato të betonizuara, në penguesit e shpejtësisë dhe më së shumti për të shënuar në trotuare, si edhe në zona të tjera me trafik.

NGJYRA: E bardhë, e verdhë dhe sipas kërkesës.

PARAPËRGATITJA: Sipërfaqja që do të bojatset, duhet të pastrohet nga mbeturinat, pluhurat, yndyrnat apo nga shtresa të mëparshme të bojës, të lidhura dobët me sipërfaqet (shtresat e fryra). Sipërfaqja duhet të jetë e thatë dhe e pastër

PËRDORIMI: RS ROAD PAINT përzihet me solvent në masën deri në 10% sipas nevojës. Duhet të përzihet mirë. Me masën e përfutur lyejmë sipërfaqen që dëshirojmë të lyejmë. Në varësi të kushtevë lysterja mund të bëhet me pistoletë, rrul ose furçë.

KUJDES: Gjatë përdorimit duhet të jeni në ambjentë të hapura me ajrim të mirë. Mos e nuhatni apo gëlltitni bojën. Mënjaroni kontaktin me lëkurën. Në rast se ju derdhet mbi lëkurë, pastrojeni menjëherë vendin me pastrues, sapun dhe me ujë. Në rast kontakti me sytë, pastrojeni me ujë të rrjedhshëm e të bollshëm, si edhe lajmëroni menjëherë ndihmën e shpejtë.

TE DHENAT TEKNIKE:

- Ngjyra.....E bardhë, e verdhë
- Imtësia.....40 – 80 µm
- Densiteti.....1.5 – 1.6 g/ml
- Fuqia mbuluese.....1 – 1.4 m²/ L
- Mbetja e thatë.....37 %
- Koha e tharjes në varësi të temperaturës15 – 60 min

REZIKSHMËRIA: RS ROAD PAINT janë të djekshme (R10), të dëmshme po të nuhaten R20), irritojnë lëkurën (R38) si dhe duhet të ruhen larg fëmijëve (S 2), (në vënde të ajrosura mirë (S 9) dhe larg burimeve të zjarrit (S 16). Po kështu, mbeturinat e bojës nuk duhen derdhur në kanalet e shkarkimit (S 29) dhe ambalazhet e përdorura duhen hedhur në vënde të sigurta (S 35).

AMBALAZHIMI: Ambalazhimi bëhet në kuti metalike 0.75 L dhe 3.75 L.

KUSHTET E RUAJTJES: Në ambalazh të mbyllur hermetikisht, të mbrojtur nga ngrica.